

„THE SKIN OF THE DOG“ AND PRESENCE OF THE MYTHOLOGICAL BEING

Gjylë TOTAJ

University of Prizren „Ukshin Hoti“, Faculty of Philology, Albanian Language and Literature

gjyla_totaj@hotmail.com

UDC 821.18-31.09

Conference paper

Abstract

The novel „The Skin of the Dog“ by Fatos Kongoli has a specific feature regarding the way of narrative aspect, and according to the points of views which give shape to the narrative development in this text. Same as in some other novels of Kongoli, also in the „The skin of the dog“, is clearly seen the insertion of narrative. It is sometimes narrated in first person and sometimes in the third. What distinguishes this Kongolian narration is also the construction of a psychological profile of the main character, which always conveys a sense of underestimation.

As in „The Dream of Damocles“ we have also here the presence of mythological beings and the presence of the element of literary fiction, as well as the relationship between the father and his child, but now with the daughter, differently to come comparing to the other novels, where we see the relation with his son. A very important segment of this novel is the thematic motif of deportation, which is one of the most used motifs in Fatos Kongoli's novels.

In „The skin of the dog“ we find the figure of Hadi who persecutes our main character during his delusional phases. The main character of this novel, Kristi Tarapi, feels himself failed and unwilling to go any further. He often refers to himself as a „dog skin“ meaning a man of no value. We have also here an intercourse with the title of the novel that, as in all the novels of Kongol, turns out to be highly motivated and interrelated with the ideas and the thematic of the novel.

Key words: *Novel, event, character, love, wife, language.*

Përmbledhje

Romani „Lëkura e qenit“ i Fatos Kongolit ka një veçori sa i përket mënyrës së rrëfimit dhe këndeve të shikimit që i japin trajtë zhvillimit të narracionit në këtë tekst. Sikurse edhe në disa romane të tjera të Kongolit, edhe te “Lëkura e qenit” vihet re ndërfaqja e vetave të rrëfimit, ku herë rrëfëhet në veten e parë e herë në tretën. Ajo që e shquan këtë rrëfim kongolian është edhe ndërtimi i një profili psikologjik të personazhit kryesor, të cilin gjithnjë e përcjellë një ndjenjë nënvlerësi.

Sikurse edhe te „Ëndrra e Damokleut“ edhe këtu e kemi praninë e qenieve mitologjike dhe praninë e elementit të fantastikes letrare, si dhe raportin mes atit me fëmijën e tij, por tash me të bijën, për dallim prej romaneve të tjerë, ku shohim raportin me të birin. Një segment mjaft i rëndësishëm i këtij romani është edhe motivi tematik i internimit, që është një nga motivet më të përdorura në romanet e Fatos Kongolit.

Te „Lëkura e qeni“ është figura e Hadit që e përndjek kryepersonazhin tonë në fazat e tij delirante. Personazhi kryesor i këtij romani, Kristi Tarapi, e ndjen veten të dështuar dhe pa ndonjë vullnet për të vazhduar më tutje. Ai shpeshherë i referohet edhe vetes si një „lëkurë qeni“ që ka kuptimin e një njeriu që nuk ka ndonjë vlerë. Këtu ndërlidhet edhe titulli i romanit, që sikur në të gjithë romanet e Kongolit, del të jetë tejet i motivueshëm dhe i ndërlidhur katërcipërisht me idetë dhe tematikën e romanit.

Fjalët kyçe: *Romani, ngjarja, personazhi, dashuria, gruaja, gjuha.*

Hyrje

Romani „Lëkura e qenit“¹ i Fatos Kongolit në qendër të diskursit të tij narrativ ka një shkrimtar e skenarist filmash, Kristi Trapin, që ka një jetë të shthurur emocionalisht, si pasojë e ngarkesave që kishte pësuar nga e kaluara jo dhe aq e largët. Ai e quan veten të dështuar e të papërmbushur, si në planin profesional, po ashtu edhe në atë emocional. Rrëfimi për të kaluarën komuniste ndërlidhet me një familje të internuarish, që ishin ndëshkuar brez pas brezi nga njerëzit e regjimit komunist të Enver Hoxhës.

Ishte familja e Doloresit, me të cilën kishte marrëdhënie jashtëmartesore personazhi ynë. Atë e kishte njohur qysh në kohën rinore, kur prisnin në radhë për ta marrë qumështin të ashtuquajturat magazina popullore e ndanin për qytetarët. Pra, kemi të bëjmë me një rrëfim për pushtet e një shtet, që nuk i lejon individin posedimin e asnjë pronësie private.

¹ Fatos Kongoli, *Lëkura e qenit*, Toena, Tiranë, 2006.

Edhe qumështin e nevojshëm për familjen dhe fëmijët duhej ta merrnin nga shteti e jo ta siguronin vetvetiu. Familja e të dashurës së tij kishte njolla biografike dhe për atë ndëshkohej thuhet secili pjesëtar i saj. Pushteti dyshonte edhe për Kristin, për shkak të afërsisë që kishte me këtë familje. Kristi Tarapit i është neveritur vetja për shkak të pamundësisë për të bërë diçka për njerëzit e tij të dashur, për shkak të frikës së tij që e kishte shoqëruar gjatë gjithë kohës.

Tri perspektivat e rrëfimit

Romani „Lëkura e qenit“ është roman befasues për shkak të shumësisë së perspektivave narrative që hasen në të. Ne me leximin dhe interpretimin tonë modest, kemi arritur që t'i identifikojmë tri perspektiva të rrëfimit, që kanë të bëjnë me zhvillimin e ngjarjes, me procedimin ideo-tematik dhe më pozicionimin e personazhit në kuadër të rrëfimit. Për ta ilustruar këtë që jemi duke e thënë, ne e pamë të udhës që t'i listojmë këto tri perspektiva:

Perspektiva e Kristi Tarapit, zhvillimi i jetës dhe krajjat e tij gjatë situatave të ndryshme;

Perspektiva e familjes armike që linçohet brez pas brezi nga pushtetarët komunistë të Shqipërisë së gjysmës së dytë të shekullit XX;

Perspektiva e ndërlidhjes mes imagjinatës dhe realitetit, mes fantastikes dhe njëmendësisë. Takimi i kryepersonazhit tonë, Kristit, me Hadin mitologjik.

Këto tri linja e përbëjnë atë që mund të quhet bosht narrativ dhe tematik të romanit

„Lëkura e qenit“ të Fatos Kongolit. Por, ka edhe aspekte e perspektiva të tjera të narracionit, që nuk e kanë këtë hapësirë e pozicion në kuadër të romanit sikurse tri të lartpërmendurat. Një aspekt a perspektivë që mund të përmendet është raporti mes të atit dhe fëmijës së tij, për të cilin do të flasim pak më vonë, si dhe koncepti i vdekjes, për të cilin flitet gjerë e gjatë në këtë roman. Tri linjat a perspektivat e lartpërmendura janë të ndërlidhura mes vete dhe japin e marrin nga njëra-tjetra.

Pra, nuk kemi të bëjmë me struktura fragmentare që dalin edhe formalisht si të tilla, por me struktura që i japin nxitje veprimit dhe njësitë e romanit i bëjnë unike përmes dimensionit tematik e ideor. Pa mëdyshje, mund të themi se shumësia e perspektivave të rrëfimit i jep sharmë estetik këtij romani të Fatos Kongolit, duke e bërë ndër veprat më të pëlqyera dhe më të përkthyerat të këtij autori. Mund të themi se pas romanit „I humburi“, „Lëkura e qenit“ është romani i dytë i përkthyer në gjuhë të botës, sa i përket veprave të këtij autori.

Profili psikologjik i personazhit

Kristi Tarapi është kryepersonazhi i romanit „Lëkura e qenit“. Rreth tij sillen të gjitha veprimet, të gjitha motivet dhe idetë që mund të dalin nga leximi dhe interpretimi i tekstit. Një gjë e tillë e bën këtë vepër të Kongolit të cilësohet si roman i personazhit, si nënloj brenda zhanrit. Një cilësor i tillë i përfshinë thuajse të gjitha romanet e këtij autori. Kristi Tarapi është një karakter që ndihet i vetmuar, sikurse shumë karaktere të romaneve të krijuesit të tij si personazh.

Përpos që ndihet i vetmuar, ai ka ndjesi të papërshkrueshme të nënvlerësimit të vetes dhe një frikë të llahtarshme nga ajo që do të mund t'i ndodh atij dhe njerëzve të tij të afërt. Një karakter i absurdit, që përpos ekzistencës individuale, nuk është se ka ndonjë interesim për gjërat e tjera. Sikurse shumica e karaktereve të Kongolit, edhe Kristi nuk është pjesë e ndonjë kauze të madhe shoqërore e politike, madje ai as nuk i honeps të tillat gjëra. Ai është karakter i papërmbytur edhe në planin emocional e erotik.

Ai është iluzionist, që vetëm tenton të këtë diç, por nuk është se bën përpjekje të mëdha e konkrete. Në këtë aspekt, në atë të dimensionit iluzionist të karakterit, Kristi Tarapi ndryshon prej personazheve të tjerë të Kongolit, që nuk e kanë këtë dimension. Kristi është një skenarist dhe shkrimtar, por që nuk ka ndonjë sukses për të thënë në punën e tij profesionale. Mossuksesi i tij në aspekt ndërlihet me rrethanat dhe tronditjet shpirtërore që atij i ndodhin gjatë viteve.

Në këtë aspekt, studiuesi i letërsisë bashkëkohore shqiptare, Arben Prendi, duke diskutuar rreth këtij romani, thekson se te „Lëkura e qenit“² kemi të bëjmë me një roman të krizës psikologjike të shkrimtarit në një kohë tranzicioni.” Duke qenë se kemi të bëjmë me një skenarist dhe shkrimtar, atëherë mund të themi se pohimi i studiuesit në fjalë na del të jetë i saktë. Përpos si roman të krizës së një shkrimtari, ky studiuesi i lartshënuar e vlerëson këtë roman të Kongolit edhe si një vepër narrative, ku shpërfaqet “kriza e familjes shqiptare në rrethanat e një tranzicioni politik”³, siç ishte ai që e kaloi Shqipëria gjatë dekadës së fundit të shekullit XX, që ishte ndër dekadat më të rënda në aspektin social e etik në historinë më të re të kombit shqiptar.

Prania e qenies mitologjike

Siç e potencuam edhe më lart, romani „Lëkura e qenit“ ka një ngjashmëri me romanin „Ëndrra e Damokleut“, jo vetëm në dimensionin tematik e ideor, por edhe me praninë e diskursit fantastik, të fantastikes letrare, e të figurave mitologjike të antikitetit. Te „Lëkura e qeni“ është

² Arben Prendi, op. cit., fq. 72.

³ Po aty, fq. 73

figura e Hadit që e përndjek kryepersonazhin tonë në fazat e tij delirante. Pra, derisa Ergysin e romanit të mëhershëm të Kongolit, në fazat e tilla delirante e përndiqte Damokleu, si shënjeshtër i fajit, Kristin e përndjek Hadi, që simbolizon përdënimin grek të vdekjes.

Heroin tonë (apo më mirë të themi anti-heroin, meqenëse ai konceptohet si i tillë), e ndjek hija e vdekjes. Ai e ndjen veten në faj për vdekjen e të shoqes, Margës, dhe një gjë e tillë i shndërrohet në një makth, sa që i shfaqen situata delirante, ku në ëndërrimet e tij e sheh veten duke u takuar dhe përndjekur nga Hadi, zoti i vdekjes të grekët e lashtë. Pra, përpos një tematizim të shkëlqyer të vdekjes, te ky roman shohim edhe një ndërlidhje tekstuale apo një intertekst me trashëgiminë kulturore, mitologjinë dhe letërsinë antike greke.

Kjo tregon edhe për një shenjë të pjekurisë intelektuale dhe kulturore të këtij autori, që në veprat e tij na jep dëshminë që nuk kemi të bëjmë vetëm me një krijues që veprat i shkruan vetëm në bazë të imagjinatës, por që ato janë edhe prodhim i leximit dhe kulturës së tij autoriale. Kjo është një nga shenjat e prozës bashkëkohore shqiptare dhe botërore. Pra, kemi të bëjmë me një kulturë intertekstuale të autorit tonë, gjë që dëshmon edhe për një formim të tij të lartë kulturor. Studiuesi francez, Zherar Zhenet, thotë se „*intertekstualiteti është prania literale ose integrale e një teksti në tekstin tjetër*“.⁴

Prania e figurës së Hadit në këtë rrëfim dhe ballafaqimi i tij me personazhin tonë na jep ngjyrimet e fantastikes letrare, që është një segment që i jep efekt stilistik e estetik romanit „Lëkura e qenit“. Një situatë që ia shton vlerën fantastikes dhe e bën edhe më të pranueshme në planin e ideve në këtë roman, është ëndërra që personazhi ynë, Kristi Tarapi, e sheh. Ai e sheh veten ëndërr duke u varrosur. E sheh veten në një kortezh funerali, edhe pse fizikisht ende është i gjallë. Kjo është një nga situatat më të realizuara në planin artistik e estetik në këtë roman. Për ta ilustruar këtë po e japim më poshtë një paragraf të kësaj sate, që thotë shumë për romanin në fjalë.

„ky (*Hadi*, *vër. jonë*) më vuri në dukje se rrëmuja ishte në kokën time. E ndjej për detyrë të të bëj me dije se i vdekuri je ti, vërejt. Dhe gjithë këta njerëz kanë ardhur për të marrë pjesë në funeralin tënd“.⁵ Prania e elementeve të tilla që e gërshtojnë realen dhe imagjinaren, fantastiken me njëmendësinë ka edhe shumë të tjera, veçanërisht në ato pjesë ku kemi përballjen e personazhit real, Kristi Tarapit, me qenien fiktive e mitike, Hadin e antikitetit grek.

⁴ Zherar Zhenet, *Figura*, Rilindja, Prishtinë, 1985, fq. 84.

⁵ Fatos Kongoli, *Lëkura e qenit*, Toena, Tiranë, 2006, fq. 83.

Raporti me fëmijët: babë-bijë

Sikurse në romanin „Ëndrra e Damokleut“ edhe këtu e kemi një raport mjaft të veçantë në mes të atit dhe fëmijëve të tij. Por, për dallim prej romanit të lartcekur, ku kemi një raport të ndërlikuar në mes të atit dhe të birit, te „Lëkura e qenit“ ky raport është në mes të atit dhe bijës së tij. I ati, Kristi, nuk është aspak i lumtur me ikjen e fëmijëve të tij, djalit në Amerikë, dhe vajzës për t’u martuar në Itali. Largimin e vajzës, Irmës, e vuan më së shumti.

Pas vdekjes së të shoqes, Margës, largimi në mënyrë të tillë i fëmijëve të tij, ngjallë te ai ndjesinë e të vetmuarit dhe njeriut me mungesa të mëdha. Arsyeja pse largimin e vajzës e vuan më shumë ka të bëjë me faktin se Kristi, i ati i Irmës, kishte një simpati erotike për mikeshën e saj, Lorin. Ai vazhdimisht shihte ëndrra erotike me Lorin, por pa mundur t’i konkretizonte. Ëndrra të tilla ai kishte edhe gjatë kohës kur e shoqja e tij ishte gjallë. Një situatë mjaft absurde, e paraqitur në këtë roman, është ajo kur edhe pse Marga ishte duke vuajtur aq shumë dhe në prag të vdekjes, Kristi shihte vazhdimisht ëndrra erotike me mikeshën e të bijës.

Pas vdekjes së Margës dhe ndarjes së Lorit nga i fejuari i saj, Kristi ishte më se i vendosur që ta jetësojë ëndrrën e tij. Një gjë të tillë natyrisht se nuk do ta honepste e bija e tij. Gjatë kohës së flirtimit të tij me Lorin, ai e kupton se ajo ishte pikërisht vajza e Doloresit, vajzës së ëndrrave të tij rinore, të cilën e kishte takuar gjatë kohës së diktaturës. Andaj, kjo është hallka e ndërlidhjes së situatave dhe kohëve në këtë roman.

Kah një roman psikologjik

Krist Tarapi, personazhi kryesor i romanit *Lëkura e qenit*, është një karakter i fushës psikologjike për studime të thella në rrafshin jo vetëm letrar, por edhe social e psikologjik. Ai identifikohet me një emër ironik, si Krist Trapi. Ai jetonte një jetë të shthurur moralisht brenda rrethit social e familjar. Ishte i martuar me Margën, vdekjen e së cilës e kishte shkaktuar ky me veprimet e tij, prej një të çmenduri. Ai e dashuron Margën, por edhe e tradhton atë, me lidhjet që krijon me femra të tjera. Këtë e rrëfen vet Tarapi, kur përshkruan jetën e tij që nga fëmijëria e tij. Ai është aventurier dhe i donë aventurat. Një pjesë e romanit merret me përshkrimin e fillimit të aventurave të tij prej njeriu imoral. Këtë e thekson në pjesën e parë të tregimit, “e pëlqeja një zonjë e cila po priste në radhë për të marrë qumësht në ora dy të mesnatës”, madje ideja e tij rreth zonjave i kalonte kufijtë racional duke bërë problem psikik mendimet dhe ndjenjat e tij duke menduar se çfarë kanë bërë zonjat gjatë natës duke fjetur në dhomat e tyre.

Në vazhdim të romanit, Krist Tarapi rrëfen takimet e tij me femrat e tjera, sidomos me zonjën e cila e kishte të shoqin në burg dhe këtë takim Krist Tarapi e sheh si një shoqërim të mungesës së dashurisë që gruaja kishte kohë që e kishte braktisur këtë ndjenjë. Sidomos rrëfimi

bëhet më psikologjizues kur Krist Tarapi shpërfaqë mendimet e tij për Lorin, shoqen e vajzës së tij dhe kur e shihte këtë vajzë i referohej vetvetes “ Lëkurë qeni” , pra Lori ishte bërë qenie e paimagjinueshme në lëkuren e tij madje kjo theksohet nga goja e tij “Kur Lori u përkul drejt meje, shqisat këmbëngulen edhe një herë të fundit se funksiononin në mënyrën me normale, dhe mendova se duke shikuar atë “unë isha një Lëkurë qeni...”⁶.

I gjithë ky material jetësor, këto parcela jete jepen në veten e parë nga personazhi-narrator Krist Tarapi i cili përjeton një krizë identiteti. I dështuar në profesion, në jetën familjare e atë intime ai ka gjithçka për të qenë një antihero. Skenat e fundit të dashurisë janë vërtet një parodi e dashurisë, si për ti provuar se asgjë nuk ka mundur kurrë ta nxjerrë nga rëndomësia e monotonia e të sublimojë ekzistencën e tij.”I cilësuar si një libër haluçinant, ku shkrimtari Fatos Kongoli arrin nivelin më të lartë të prozës, „Lëkura e qenit“ ka rrëmbyer kritika mjaft pozitive dhe po përkthehet në disa gjuhë të huaja.

Në krijimtarinë e shkrimtarit ai ishte ura e kalimit nga një sferë krijimtarie në tjetrën, duke e lënë pas ciklin prej katër romanësh me titull "Burgjet e kujtesës". Larg rrëfimit të errët të „Ëndrrës së Demokleut“, me një stil më të lirshëm se tek „I humburi“ apo „Dragoi i fildishtë“, romani „Lëkura e qenit“ e godet ndryshe lexuesin e Kongolit. Personazhet e këtij libri të kujtojnë dëshira dhe vese që çdokush i mban fshehur nën vete, që çdokush i prek e i ledhaton, i fundos në thellësi të vetëdijes, pa i lënë kurrë të dalin krejtësisht të zhveshura nën vështrimin e të tjerëve, pra ky roman do të duhej të na ofronte jetën të cilën e jetojmë si realitet objektiv.

Sipas Edvin Mjur “romani duhet të na ofroj “jetën”, do të pajtohej Luboku me zotëri Forsterin, por njëherit do të pyeste ç’është jeta dhe ku qëndron diferenca në mes të jetës, të cilën e jetojmë dhe jetës të cilën e vërejmë te romani”⁷. Si një libër haluçinant, ku fytyra e shëmtuar e botës vetëm rrallë, të lejon të shohësh anën tjetër të medaljes, fytyrën e bukur të saj, romani *Lëkura e qenit*, i ngjan një udhëtimi në kohë, ku herë ecën përpara, e herë kthehesh mbrapsht, tutje, thellë në vitet, ku has dëshirat e para prej fëmije.

Megjithëse stina e moshës së vonë, në jetën e një burri të quajtur Kristë Tarapi, është panorama e parë që shfaqet. Rrëfimi nis në kujtimet e këtij personazhi, kur ishte veçse fëmijë, dhe kishte zbuluar fytyrën e parë, të bukur të kësaj bote, nënën. Edhe pse me rrëfim prej fëmije, personazhi kryesor që gjithmonë flet në vetën e parë, arrin të japë atmosferën e kohës, kur sapo kishin nisur përndjekjet dhe vuajtjet në botën e “*Hadit*”⁸(kohën e diktaturës në Shqipëri).

⁶ Fatos Kongoli, *Lëkura e qenit*, Toena, Tiranë, 2006, fq. 67.

⁷ “Çështjet të romanit”, grup autorësh , *Rilindja*, Prishtinë 1980, fq. 176.

⁸ Fatos Kongoli, *Lëkura e qenit*, Toena, Tiranë, 2006, fq. 5-7.

Një fëmijë që ka pasur përreth gjithmonë histori përndjekjesh, internimesh, e ndarje të dhunshme njerëzish. Kjo deri në moshën e vonë të tij, kur historitë vijojnë të jenë gjallë e të ngrenë krye nëpër kujtime dhe ëndrra. E paralelisht me këto histori ai ka pasur përreth vetes femrat që mundën të hyjnë në jetën e tij të trazuar, mbushur plot me gabime e mëkate njerëzore. Ato, gjithmonë i pa, si fytyra e bukur e botës, që nga Liza, mësuesja e bukur, Dolora, vajza e saj të cilën Kristi e njohu grua, dhe deri tek Lori, vajza e veshur në ngjyrë vishnje, ajo që e trazon në ëndrrat e tij erotike dhe e fton drejt së ardhmes.

Të tria këto femra, që sjellin tre breza, dhe tre shenja dashurish në jetën e tij, janë rruga përmes të cilës ai gjithmonë ka dashur të arratiset. Një arratisje përmes portreteve të tyre që gjithmonë kishin një ngjashmëri të çuditshme. E para Liza, e dyta Dolora (vajza e Lizës) dhe e treta Lori (vajza e Dolorës). Me „Lëkuren e qenit“, Kongoli e ndjen sikur i ka kthyer edhe borxhin më të fundit viteve të rinisë dhe më në fund është i lirë të kthejë një tjetër faqe në krijimtarinë e tij.

Tashmë që kujtesa i është çliruar nga ato pengje dhe ato dhimbje, ka vendosur të shkruajë një tjetër jetë. Për të shkruar deri tek „Lëkuren e qenit“, në atë që vetë e quan si librin e tij me te mirë, Kongoli do të duhej të kalonte nëpër një rrugë të gjatë. Do t'i duhej ta kalonte njëherë atë "ferr" që më pas të mund ta përjetonte në librat e tij, do t'i duhej të bënte pikërisht jetën që ka bërë, të gjitha zgjedhjet, që ndonëse edhe pa dëshirën e tij.

Përfundimi

Si përfundim i gjithë këtij punimi, mund të themi se Kongoli është ndër autorët më të rëndësishëm të letërsisë së sotme shqipe. Proza romanësore e Fatos Kongolit na ofron mundësi të shumta interpretimi dhe diskutimi për të. Kongoli si prozator është specifik në mënyrën e modelimit të narracionit, me një lëvizje të kohëve dhe perspektivave të rrëfimit. Një lëvizje e tillë, sa në të tashmen e sa në të kaluarën është shënjuese e mënyrës së rrëfimit të këtij autori. Përpos lëvizshmërisë së kohëve, kemi edhe lëvizje të hapësirave të rrëfimit, ambienteve në të cilat e për të cilat zhvillohet rrëfimi. Një lëvizje e tillë i jep ngjyrë romaneve të tij dhe i bën më të këndshëm për lexim dhe më të kapshëm për interpretim dhe analizë të tyre.

Bibliografia

“Çëshjet të romanit”, grup autorësh, përktheu dhe përzgjodhi Hysni Hoxha, Rilindja, Prishtinë, 1980

KONGOLI, Fatos: “Lëkura e qenit”, roman, Toena, Tiranë, 2006

DADO, Floresha: “*Teoria e veprës letrare*”, *Poetika*, SHBLU, Tiranë, 2003

SOLAR, Milivoje: “Teoria e letërsisë”, Rilindja, Prishtinë, 1978, f. 202

TODOROV, Tzvetan: “*Poetika e prozës*”, përkth. Anton Papeleka dhe Gjovalin Kola, Panteon, Shtëpia e Librit, Tiranë, 2000

XHAFERRI, Hamit: “Romani “Lëkura e qenit” i Fatos Kongolit, Seminari XXVIII Ndërkombëtar i Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare, nr. 28/2, Prishtinë, 2009

ZHENET, Zherar: “*Figura*”, Rilindja, Prishtinë, përkth. Sabri Hamiti dhe Binak Kelmendi, Rilindja, 1985.